

URDHËR
Nr. 23, datë 13.1.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “P”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Mbrojtjes, drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, z. Ardit Çollaku.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga drejtori i DPRRPFM-së menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Drejtori i DPRRPFM-së nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

5. Urdhri (autorizimi) nr. 295/2, datë 8.2.2018 “Për ushtrimin e përgjegjësisë të titullarit të Autoritetit Kontraktor për blerjet me vlera të vogla dhe sistemin dinamik të biletave të transportit ajror”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

TTTULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Niko Peleshi